



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:028640

Datë: 10.05.2022

Numri i dokumentit: 02988850

P.nr.99/22

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Veli Kryeziu, me zyrtaren ligjore Fikrije Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit R.S nga Gjilani, lagja "I", për shkak të veprës penale, Vjedhja e Sherbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.223/2022, të datës 10.02.2022, kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr. 223/2022, të datës 08.03.2022, më datën 05.04.2022, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit : R.S nga Gjilani, rruga "I", i lindur më 18.10.1969, në Gjilan, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Më datë 15.11.2021, në Gjilan Lagj. "I", pas vërtetimit të gjendjes faktike të njehsorit elektrik, nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se, i pandehuri R.S si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik, dhe në këtë mënyrë ka bërë harxhimin e paautorizuar të energjisë elektrike, me çka ka pa mundur regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike, duke e dëmtuar, të dëmtuarën KEDS- distrikti në Gjilan në, vlerë prej 107.44 Euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e sherbimeve nga neni 314 paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38,69,70,71,72,81 dhe 82 të KPKK-së, si dhe neni 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurës i shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

Ashtu që i pandehuri R.S i behet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rezikshme, që përben veprë penale për të cilën nëse ai sërish kryen veprë të tillë, Gjykata do të shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin juridiko civil

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 (njetzet euro) në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të R.S nga Gjilani për shkak të veprës penale Vjedhje e sherbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s . Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet Verejtje gjyqësore, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit R.S, dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor.

Në bazë të deklaratës së të pandehurit, e përfaqësuesit të dëmtuarit, deklaratën e dëshmitarëve dhe foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri R.S nga Gjilani për shkak të veprës penale Vjedhje e sherbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e PTH dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.99/22, Më 05.04.2022

Zyrtare Ligjore,

Fikrije Rexhepi

Gjyqtari,

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimi të njëjtit.